



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.311/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi -anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

- I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.311/2025 e datës 02.02.2025.
- II. Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 3,000.00 (tremijë) euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 02.02.2025 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se në postimin e kandidatit për deputet nga subjekti Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), z. Shaban Osmanaj janë një postuar disa fotografi në një takim me qytetarë ku vërehet edhe kandidati tjetër nga radhët e LDK, z.Driton Selmanaj, ku të dy së bashku shkelin Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024, konkretisht Neni 5 par 2 nën par 2.4 të së njëjtës, i cili shprehimisht ndalon në fushatën e zgjedhjeve, nuk mund të përfshihen kategoritë e personave, si në vijim, ndër ta në pikën 2.4 edhe: 2.4. *të punësuarit në organizatat bamirëse dhe fetare;*

Më tutje në ankesë është theksuar se nga provat e bashkangjitura, kandidati z. Osmanaj në postimin e tij vetë përshkruan gjendjen faktike se janë takuar me një pjesëtar të Bashkësisë Islame të Kosovës, cili është Sheh Përparimi djali i Sheh Shaipit, nga fshati Plenajë i Hasit.

Sipas parashtruesit të ankesës theksohet se kandidati në fjalë përveç se takohet me të punësuar në organizata bamirëse, i njëjti thotë se e ka përkrahjen e këtij institucioni me fjalinë, po citoj: *“Jam i lumtur që, sikur edhe prej shumë prijësve fetarë në Has e me ndikim të madh, njëjtë të kem mbështetjen e sheh Përparimit në rrugëtimin tim për deputet”*. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se përmes këtij veprimi, subjekti përkatës ka cënuar dispozitat përkatëse ligjore dhe rregullative, andaj duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, ka kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur postimin e kandidatit Shaban Osmanaj dhe Sheh Përparimi në organizime dhe ceremoni fetare të organizuara nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK)

PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.02.2025, subjekti politik LDK ka theksuar se pretendimi se kandidati për deputet z. Shaban Osmanaj me rastin e postimit në rrjetin e tij social facebook nuk përbën asnjë shkelje të nenit 5 par.2, nën par 2.4 të Rregullores Zgjedhore 07/2024, sepse e para pretendimi se z. Osmanaj është takuar me një pjesëtar të Bashkësisë Islame të Kosovës nuk qëndron, sepse Bashkësia Islame e Kosovës nuk njihë tarikatet të cilat janë dhe cilësohet si kategori jokushtetuese dhe nuk bëjnë pjesë as në organizata fetare e as bamirëse, sepse nuk kanë rregullim ligjor e as kushtetues. Ankuesi nuk ka arritur ta provoj se z.Perparim është pjesëtar i BIK-ut, gjithashtu ka abuzuar me të drejtën e ankesës kur postimin e z. Osmanaj e ka devijuar plotësisht duke shtuar diçka tjetër nga ajo që është shkruar (*shihni postimin në faqen dy të ankesës si foto dhe tekst dhe krahasojeni me paragrafin e fundit të faqes së parë të ankesës*). Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara, jo bindëse dhe nuk kanë arritur të dëshmojnë të qenit ligjërisht pjesëtar i BIK-ut në Kosovë, me ndonjë akt emërim apo të ngjashme, por vetëm me hamendje e kanë pretenduar një gjë të tillë, të mos-qenit kategori kushtetuese e as ligjore, të njëjtit — pjesëtarët e secilit tarikat i konsideron vetem qytetar të thjeshtë të Republikës së Kosovës. As pretendimi se kandidati Osmanaj është takuar me të punësuar në organizata bamirëse nuk qëndron, sepse nuk është faktuar as provuar një gjë e tillë, as me ndonjë certifikatë të regjistrimit të organizatës si OJQ apo të ngjashme as me ndonjë kontratë punësimi të z.Perparim, që përmendet në ankesë.

Duke marrë parasysh ato që u ceken me lartë ka kërkuar nga PZAP që të marr vendim meritor për rastin në fjalë dhe duke u bazuar në krejt ato që u thanë ka kërkuar që ankesa e subjektit LVV të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është bazuar

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik LDK Shaban Osmanaj në postimin e datës 02.02.2025 në llogarinë e tij të facebook-ut me qëllim të përfitimit të votave ka bërë fushatë me përfaqësues fetar (SHEH) në fshatin Planejë e Hasit. Nga prova materiale e bashkangjitur

ankesës, nga subjektit politik LLV dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidatit për deputet Shaban Osmanaj dhe kandidati tjetër për deputet Driton Selmanaj nga radhët e subjektit politik, LDK, është shkëlur Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që kandidatët në fjalë, me qëllim të promovimit të kandidaturës së tyre për deputet, kanë bërë fushatë zgjedhore me përfaqësues fetar, duke i përfshirë në fushatë zgjedhore përfaqësues fetar, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024 që përcakton se në fushatën zgjedhore nuk mund të përfshihen kategoritë e personave të punësuar në organizata bamirëse dhe fetare.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e lartpërmendura janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi si të bazuara, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Sipas vlerësimit të panelit pretendimet në përgjigje në ankesë se ankuesi nuk ka arritur që të provoj se z.Përparim është pjesëtar i BIK dhe ka abuzuar me të drejtën e ankesës janë të pabazuara për arsye se në postimin në rrjetin social Facebook të kandidatit për deputet, vërehet se kandidatët për deputet kanë realizuar takimin me përfaqësues fetar, në kohë fushate e me qëllim të përfitimit të votave.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor. Kjo konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e kandidatëve për deputet të subjektit politik LDK për fushatë zgjedhore duke u takuar me përfaqësues fetar është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, dhe nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.311 /2025 më datën 05.02.2025

Kryesues i Panelit
Bujar Muzaqi



Këshilla Juridike: Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform neni 118 par. 4 të LZP-së.